VENDIM
Nr.228, datë 11.7.1990

PËR RIORGANIZIMIN E SHKËMBIMEVE DHE TË ARTIZANATIT

Këshilli i Ministrve, duke pasur parasysh konkluzionet e Plenumit të 11-të të Komitetit Qendror të Partisë për nevojë të përmirësimit rrënjësor të punës në sektorët e shërbimeve dhe të artizanatit,

VENDOSI:

1.Të riorganizohet në tërësi fusha e gjerë e shërbimeve (komunale, jetësore, tregtare) dhe të artizanatit.Për këtë të punohet paralelisht në tri drejtime:

a) Të përmirësohet puna në ndërmarrjet shtetërore të shërbimeve e të artizanatit, duke zbatuar sipas specifikës së tyre kërkesat e mekanizmit të drejtimit me llogari më vete, e cila të funksinojë në çdo njësi e dyqan.

b) Me iniciativë, sipas kushteve, të krijohen edhe kooperativa të artizanatit. Në këtë rast mjetet kryesore dhe velgat e punës kalojnë në pronë grupi, kundrejt pagesës.

c) Zanatçinjtë, duke përfshirë edhe ata të tregtisë së vogël, të lejohen për të kryer shërbime individualisht si privatë, në shtëpi, në rrugë, në dyqane e në pika ambulante.

2. Në ndërmarrjet dhe në kooperativat e artizanatit, krahs investimeve e furnizimeve mme plan, çdo njësi vetëvepron për sigurimin e lëndëve të para dhe po kështu edhe për caktimin e çmimeve, për modelet etj., në përputhje me kriteret e përcaktuara me dispozita të veçanta.

3. Marrëdhëniet e njësive me ndërmarrjen ose kooperativën e artizanatit dhe të këtyre të fundit me shtetin ndërtohen mbi bazën e detyrimeve financiare që përcaktohen periodikisht në shumë absolute. Ato përfshijnë: pjesën e produktit për shoqërinë (tatim-fitimin), fondin e amortizimit, një prim sigurimi për fondet kryesore, si dhe kuotën e sigurimeve shoqërore.

4. Paga e punonjësve, në çdo njësi e dyqan, në ndërmarrjet e në kooperativat e artizanatit, formohet nga të ardhurat që mbeten pas shlyerjes së shpenzimeve të prodhimit dhe të detyrimeve financiare.

5. Artizanati ose tregtari që punon privatisht, vetëm apo me një ortak, mund të të angazhojë në shërbim edhe pjestarë të familjes, por jo të punësojë mëditës. Ata duhet të kenë lejen e ushtrimit të profesionit dhe librezën shëndetësore, të përballojnë detyrimin financiar taksë për të ardhurat që realizojnë dhe të sigurojnë veten për pensionin dhe sëmndshmërnë. Tarifat mbi të ardhurat e individëve që ushtrojnë privatisht zeje ose profesione të ndryshme, caktohen nga Ministria e Financave.

6. Ushtrimi i zejes apo i profesionit pa leje dënohet si kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobë gjer në 1000 lekë dhe deri në marrjen e mjeteve të punës nga përgjegjësi i seksionit të financës dhe të kontroll-revizionit e të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhen ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë.

7. Artizanati dhe shërbimet të shkëputen nga sistemi i ekonomisë komunale dhe të kalojnë në sistemin e industrisë së lehtë, ndërsa shërbimet tregtare private të kalojnë në sistemin e tregtisë, si në qendër, ashtu edhe në rrethe.

8. Vendimi i Këshillit të Minstrave nr.180, datë 15.12.1969 “Për ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes, të zejtarisë e të profesionit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI